



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Ne bazë të nenit 47 paragrafi 1 pika 6 të Ligjit për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 158/10, 123/12 dhe 43/14) dhe neni 35 paragrafi 1 të Ligjit për punë valutore („Gazeta zyrtare e RM”, nr. 34/01, 49/01, 103/01, 51/03, 81/08, 24/11, 135/11 dhe 188/13), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë mori këtë

VENDIM

për mënyrën e formimit dhe publikimit të kurseve të këmbimit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë

1. Me këtë vendim, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Banka Popullore) përcakton mënyrën e formimit dhe publikimit të kurseve të këmbimit të valutave të huaja në denarë.
2. Banka Popullore e formon kurse mesatare për valuta të huaja, të përcaktuara në Listën e kursit të këmbimit të Bankës Popullore (në tekstin e mëtejshëm: Lista e kursit të këmbimit) e cila është dhënë në shtesën 1 të këtij vendimi.

Kursi mesatar përcakton çmimin në denarë për një njësi valutë të huaj, i rrumbullakuar në katër numra pas presjes dhjetore.

Në bazë të ligjit për punë valutore, kursi mesatar përdoret për qëllime të kontabilitetit, për të shprehur asetet dhe detyrimet në valutë të huaj, në pajtim me rregullat e kontabilitetit dhe nevojat e bilancit.

3. Kursi mesatar i euros, përcaktohet çdo ditë në orën 16.00, si vlerë mesatare e kuotimeve të kurseve të blerjes dhe të shitjes së euros kundrejt denarit nga bankat mbështetëse të tregut valutor, duke përdorur formulën:

$$SV = \frac{\sum_{i=1}^n A_i}{n}$$

Ku:

SV = vlera mesatare e kuotimeve të kurseve të blerjes dhe të shitjes së euros kundrejt denarit nga bankat mbështetëse të tregut valutor në ditën e përcaktuar;

A_i = vlera mesatare e kuotimeve të kurseve të blerjes dhe të shitjes së euros kundrejt denarit nga banka mbështetëse e tregut valutor i , e përcaktuar sipas paragrafit 4 të kësaj pike;

n = numri i bankave mbështetëse që paraqesin kuotime të kurseve të blerjes dhe të shitjes së euros kundrejt denarit.

Vlera mesatare e kuotimeve të bankës mbështetëse të tregut valutor llogaritet nga kuotimet e kurseve të blerjes dhe të shitjes të cilat janë në kuadër të margjinave të përcaktuara për devijim nga kurset e intervenimit të Bankës Popullore.

Margjinat e devijimit të kuotimeve të kurseve të blerjes dhe të shitjes së euros kundrejt denarit nga bankat mbështetëse të tregut valutor, përcaktohen duke hequr/shtuar 0.07 denarë për euro nga kursi i intervenimeve për blerje/shitje i Bankës Popullore.

Vlera mesatare e kuotimeve të bankës mbështetëse të tregut valutor llogaritet çdo ditë pune, në orën 16, duke përdorur formulën:

$$A_i = \frac{\sum_{j=1}^t \frac{Bid_{ij} + Ask_{ij}}{2}}{t}$$

$\forall Bid_{ij} \geq (\text{kursi i intervenimit për blerje} - 0.07)$ dhe $\forall Ask_{ij} \leq (\text{kursi i intervenimit për shitje} + 0.07)$

Prej nga:

A_i = vlera mesatare e kuotimeve të bankës i ;
 Bid = kuota për blerje të euros nga banka i ;
 Ask = kuota për shitje të euros nga banka i ;
 t = numri i kuotimeve të bankës i ;
 j = numri rendor i kuotës i bankës i ;

kursi i intervenimit për blerje = kuotë për blerje të euros për denarë e përcaktuar nga Banka Popullore;

kursi i intervenimit për shitje = kuotë për shitje të euros për denarë e përcaktuar nga Banka Popullore.

Për llogaritjen e vlerës mesatare nga kuotat e kurseve për blerje dhe shitje nga bankat mbështetëse të tregut valutor, është e nevojshme që më së pakti dy banka mbështetëse të paraqesin kuota.

Në qoftë se kuota paraqet vetëm nga një bankë mbështetëse, atëherë kursi mesatar për atë ditë merret kursi mesatar i ditës së mëparshme.

4. Kursi i mesatar për valutat tjera të Listës së kursit të këmbimit llogaritet në bazë të kurseve referente ditore të euros kundrejt valutave përkatëse, të publikuara nga Banka Qendrore Evropiane.

Në rast se Banka Qendrore Evropiane nuk publikon kurse referente ditore, kurs i mesatar për valutat tjera të Listës llogaritet në bazë të kurseve të tregut, të publikuara në sistemet informative elektronike për tregjet financiare.

5. Banka Popullore i aplikon kurset mesatare për valutat e Listës së kursit të këmbimit, nga numri rendor 1 deri në numrin rendor 10, duke shtuar dhe hequr nga 0.5%, si kurs për shitje dhe blerje në transaksionet me autoritetet shtetërore.

Përrjashtim nga paragrafi 1 i kësaj pike, Banka Popullore e aplikon kursin mesatar nga Lista e kursit të këmbimit:

- Për transaksione të shitblerjes me autoritetet shtetërore të cilat zhvillohen të njëjtën ditë dhe kur për pagesat e organeve shtetërore drejt vendeve të jashtme shfrytëzohen mjetet nga llogaria valutore e organeve shtetërore që gjendet në Bankën Popullore, bëhen në të njëjtën valutë me të cilën bëhet pagesa, dhe
- Në rast të transfereve nga dhe drejt revolving llogarive valutore kreditore të organeve shtetërore që mbahen në Bankën Popullore.

Kurset e shitjes dhe të blerjes nga paragrafi 1 i kësaj pike publikohen në faqen e internetit të Bankës Popullore.

6. Lista e kursit të këmbimit publikohet ne internet faqen e Bankës Popullore, si dhe ne sistemet informative elektronike për tregjet financiare ndërkombëtare, më së voni deri në orën 17:00 çdo ditë pune dhe vlen deri ne orën 00:00 ditën tjetër, deri në hyrjen në fuqi të Listës së re të kursit të këmbimit.
7. Ditën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi nuk vlen më Vendimi për mënyrën e formimit dhe publikimit të kurseve valutore të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë („Gazeta zyrtare e RM”, nr. 13/2010).
8. Ky vendim hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit në „Gazetën zyrtare të RM” dhe do të aplikohet nga 1 korrik 2014.







V. nr. 02-15/III-3/2014
27 mars 2014
Shkup

Guvernator
dhe Kryetar i
Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë
Dimitar Bogov

Shtesa 1

Lista e kursit të këmbimit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë e formuar me datë _____ dhe e cila aplikohet nga 00:00 me datë _____ deri në hyrje në fuqi të Listës së re të kursit të këmbimit

		Shteti	Shifra	Valuta		Njësi valutore	Kursi mesatar në denarë
1.		UEM	978	Euro	EUR	1	
2.		SHBA	840	Dollari Amerikan	USD	1	
3.		Britania e Madhe	826	Paundi Britanik	GBP	1	
4.		Zvicra	756	Franga Zviceriane	CHF	1	
5.		Suedia	752	Korona Suedeze	SEK	1	
6.		Norvegjia	578	Korona Norvegjeze	NOK	1	
7.		Japonia	392	Jeni Japonez	JPY	1	
8.		Danimarka	208	Korona Daneze	DKK	1	
9.		Kanada	124	Dollari Kanadez	CAD	1	
10.		Australia	036	Dollari Australian	AUD	1	
11.		Bullgaria	975	Leva Bullgare	BGN	1	
12.		Republika Çeke	203	Korona Çeke	CZK	1	
13.		Hungaria	348	Forinta Hungareze	HUF	1	
14.		Polonia	985	Zloty Polonez	PLN	1	
15.		Romania	642	Lei i Ri Rumun	RON	1	
16.		Kroacia	191	Kuna Kroate	HRK	1	
17.		Turqia	949	Lira Turke	TRY	1	
18.		Rusia	643	Rubla Ruse	LTL	1	
19.		Brazili	076	Reali Brazilian	RUB	1	
20.		Kina	156	Juani Kinez	BRL	1	
21.		Hong Kong	344	Dollari i Hong Kongut	CNY	1	
22.		Indonezia	360	Rupia Indoneziane	HKD	1	
23.		Izraeli	376	Shekeli Izraelit	IDR	1	
24.		India	356	Rupia Indiane	ILS	1	
25.		Korea Jugore	408	Voni Koreanojugor	INR	1	
26.		Meksika	484	Peso Meksikane	KRW	1	
27.		Malajzia	458	Ringiti Malajzian	MXN	1	

28.		Zelanda e Re	554	Dollari i Zelandës së Re	MYR	1	
29.		Filipinet	608	Peso Filipineze	NZD	1	
30.		Singapuri	702	Dollari i Singapurit	PHP	1	
31.		Tailanda	764	Bahti Tailandez	SGD	1	
32.		Afrika Jugore	710	Randi Afrikanojugor	THB	1	
33.		UEM	978	Euro	ZAR	1	